



Smaltoxyl Hydro Teak Oil

Vaj mbrojtës për dru tik dhe ekzotikë me bazë uji



Rendimenti i mbulimit: 12 - 15 m²/lt



Koha e tharjes: ½ - 1 orë



Hollimi: Gati për përdorim



Mundësia për shtresë të dytë: 2 - 3 orë



Paketimi: 750 ml, 2,5 lt

Aplikimi: Me furçë, leckë

KARAKTERISTIKA TË PËRGJITHSHME

Vaj i ngopur me bazë uji me një përbërës të përshtatshëm për mbrojtjen e sipërfaqeve prej druri për aplikim në mjedise të jashtme. Falë përbërjes së tij të veçantë, ai depërton në sipërfaqen prej druri, duke ofruar mbrojtje ndaj lagështirës, tharjes dhe çarjeve, pa ndryshuar bukurinë natyrore të drurit të fortë.


Siguron mbrojtje të shtuar kundër ndotjes së ajrit, rritjes së mykut, gjërryerjes dhe rrezatimit diellor për shkak të filtrave të veçantë UV që përmban.

Ideal për mbrojtjen e drurëve të fortë si druri tik, mogani, iroko, etj. I përshtatshëm edhe për sipërfaqe të jashtme prej druri si pjergulla, orendi, tarraca, etj.

Thahet shpejt dhe nuk formon shtresë.

SPECIFIKIMET TEKNIKE

Graviteti specifik	1,00 - 1,04 kg/lt.
Rendimenti i mbulimit	12 - 15 m ² /lt në varësi të aftësisë përthithëse të një sipërfaqeje të përgatitur siç duhet.
Hollimi	Gati për përdorim
Koha e tharjes	Thahet për ½ - 1 orë.
Mundësia për shtresë të dytë	2 - 3 orë pas aplikimit. Këto afate kohore janë më të gjata në kushte të ftohta moti dhe me lagështirë.
Kategoria e POA	"Bojëra të thithshme nga druri". Lloji Y. Vlera e pragut të POA-së = 130 gr/lt. Përmbajtja maksimale e POA-së për produktet e gatshme = 45 gr/lt. POA: përbërësit organik të avullueshëm me pikën e zierjes < 250 °C.
Larja	Të paktën 7 ditë pas aplikimit duke përdorur detergjent të butë. Rekomandohet të mos përdoret ujë me presion.
Ngjyra	E gatshme edhe pa ngjyra.



PËRGATITJA E SIPËRFAQES

Sipërfaqja duhet të jetë e thatë, e pastër nga pluhurat, yndyra, vaji, boja e vjetër e cimentosur, copëza të shkëputura, etj., dhe pa gjurmë rrëshire apo produkte mbrojtëse të aplikuara më parë. Sipërfaqet e gërryera duhet të zmerilohen derisa të shfaqet druri i zhveshur. Në rastin e drurit të planifikuar për pamje me shkëlqim/saten, gërrvishteni lehtë me letër zmerile të imët. Kjo ndihmon për të hapur poret dhe lejon depërtimin e Smaltolux hydro TEAK OIL.

APLIKIMI

TEAK OIL HYDRO është i gatshëm për përdorim. Përziheni mirë përpara aplikimit. Vendosni një shtresë Smaltolux hydro TEAK OIL përgjatë vijave të drurit. Me të humbasë pamjen e tij "të lagësht" (thahet), vendosni shtresën e dytë. Përsëritni të njëjtin proces nëse është e nevojshme. Në rastin kur druri është poroz, si dhe në kushte ekstreme si ekspozimi i vazhdueshëm në rrezet e diellit, në zona të lagështa, etj., vendosni 3-4 shtresa Smaltoxyl hydro TEAK OIL. Rekomandohet që Smaltoxyl TEAK OIL të aplikohet një herë në vit për mirëmbajtje dhe mbrojtjen e duhur dhe afatgjatë të sipërfaqes së drurëve.

PASTRIMI I MJETEVE

Gjatë punës, mbajini mjetet "të njoma" në enë ose në tabakanë me bojë. Kullojeni bojën mirë nga mjetet kur ta hidhni përsëri në kuti dhe pastrojini ato me ujë të ngrohtë me sapun. Nëse boja thahet, ajo mund të hiqet vetëm me detergjente të fortë. Mos i zbrazni ujërat që keni larë mjetet në ujërat nëntokësorë.

KUSHTET E APLIKIMIT

Temperatura 8 - 30°C dhe niveli relativ i lagështisë më i ulët se 80 %. Kushtet e këqija gjatë aplikimit mund të ndryshojnë vetitë e produktit në fund.

RUAJTJA

Ruajini në një vend të freskët, mbroni materialet nga ngrirja dhe ekspozimi në diell. Mbylleni fort enën pas aplikimit. Rimerreni bojën që ka tepruar për ta përdorur përsëri. Ripërdorimi i ngjyrave mund të minimizojë ndjeshëm efektet në mjedis të ciklit të jetës së produkteve.

UDHËZIME PËR PËRDORIM TË SIGURT

Lexoni etiketën përpara përdorimit. Mbajeni larg fëmijëve. Më shumë informacion mund të gjeni në Fletën e të Dhënave të Sigurisë së Materialit të produktit (FDSP).

Të dhënat dhe udhëzimet teknike në këtë broshurë teknike bazohen në testet laboratorike dhe janë rezultat i njohurive dhe përvojës së stafit shkencor të shoqërisë. Cilësia e produktit garantohet nga shoqëria, i cili është në përputhje me kërkesat e ISO 9001,14001 dhe me rregulloren e EMAS. Si prodhues, ne nuk mbajmë asnjë përgjegjësi për asnjë dëm apo dëme të shkaktuara nëse produkti nuk është aplikuar për përdorimin e duhur dhe në përputhje me udhëzimet për përdorimin.